



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË

EITI SHQIPËRI
SEKRETARIATI KOMBËTAR I NISMËS PËR TRANSPARENCË NË
INDUSTRINË NXJERRËSE

VENDIM

Nr. 1, datë 24. 01. 2020

Grupi Ndërinstitucional i Punës EITI i ngarkuar me zbatimin e aktivitetit EITI në Shqipëri, pasi u njoh dhe diskutoi në Mbledhjen MSG-së të datës 24 Janar 2020 ndryshimet në Listën e Kompanive që do të raportojnë për Raportin EITI 2017-2018, Planin e Punës për Vitin 2020, diskutoi veprimet që do të ndërmarren për Corrective Actions të dala nga Validimi i II, vijoi me marrjen e Vendimeve të mëposhtme.

Për sa më sipër, Grupi Ndërinstitucional i Punës EITI Shqipëri,

VENDOSI

1. Për Raportin EITI 2017- 2018 do të raportojnë, sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi:
 - Të gjitha Kompanitë aktive të Hidrokarbureve (prodhimi dhe kërkimi), **10 kompani**.
 - Përsa i përket sektorit të prodhimit të hidro-energjisë, MSG-ja ka rënë dakort që **15 kompanitë më të mëdha që operojnë në këtë sektor** (rreth 91% e prodhimit të energjisë) do të mbulohet nga Raporti EITI 2017-2018.
 - Përsa i përket sektorit minerar, **138 kompani minerare** të cilat mbulojnë përafërsisht 91% të prodhimit total.
 - Në mënyrë që të sigurohet një proces rakordimi i arsyeshëm, MSG-ja vendosi që kompanitë e sektorit minerar që do të marrin pjesë në Raportin EITI 2017- 2018 do të jenë kompanitë të cilat kanë realizuar të ardhura vjetore > USD 150,000 kombinuar me sasinë e prodhimit për vitin përkatës.
 - Për secilin vit, listat do të jenë të ndryshme por në përputhje me kërkesën e

mësipërme.


- Në total Raporti EITI 2017- 2018 do të mbulojë:
 - a) Të dhëna të marra nga 8 agjenci shtetërore dhe 6 njësi vendore;
 - b) 15 lloje pagesash të bëra nga rreth 163 kompani dhe agjenci të tjera shtetërore ose qeverisje lokale;
 - c) 10 kompani nga sektori hidrokarbur; (100 % e Sektorit);
 - d) 15 kompani nga sektori i hidro-energjisë; (91 % e Sektorit);
 - e) 138 kompani nga sektori minerar (91 % e Sektorit);
- 2. Miratimin e Planit të Punës për vitin 2020.
- 3. Mori vendim për veprimet që do të ndërmerren për Corrective Actions të dala nga Validimi i II si më poshtë:
 - a) Nga ana e MSG të draftohet dhe niset një shkresë informuese për Ministren e Infrastrukturës dhe Energjisë në lidhje me Corrective Actions të dala nga Validimi dhe masat që duhen ndërmarrë për ti plotësuar ato.
 - b) Nga ana e MSG të draftohet dhe niset një shkresë për Shoqatën për Autonominë Vendore ku të kërkohet bashkëpunimi i tyre për publikimin në websitet zyrtare të Bashkive të taksave vendore që ato përfitojnë dhe që lidhen me shfrytëzimin e burimeve natyrore në zonat përkatëse.
 - c) Nga ana e MSG të draftohet dhe niset një shkresë për Institucionet si AKBN dhe ALBPETROL për të kërkuar bashkëpunimin e tyre për plotësimin e Corrective Actions.
- 4. Nga ana e Administratorit të Pavarur të kërkohet raporti i KLSH-së nga Institucionet Shtetërore raportuese për vitin ushtrimor të cilit i referohet raporti (në rastet që i kanë).

Ngarkohet Sekretariati Shqiptar EITI për ndjekjen dhe zbatimin e këtij Urdhëri.

Ilir Bejtja

**Zëvendës Ministër i Ministrisë së
Energjisë dhe Industrisë dhe**

**KRYETAR
Grupi Ndërinstitucional i Punës
EITI Shqipëri**



Adresa: Bulevardi Zhan D'Ark, Ish godina ME, Kati IV., Tirana, Albania Tel : +355 4 2264645,
sekretariati@albeiti.gov.al
www.albeiti.org